

Mazreku: Urgjentisht të obligohet sigurimi i punëtorëve në ndërtimtari



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AMBASADORI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) NË KOSOVË,
JEFFREY HOVENIER, MBAN TAKIM ME GAZETARË

HOVENIERI THOTË SE KËRKESAT E SHBA-SË NDAJ KOSOVËS NUK JANË PRESION



Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se Kosova nuk mund të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian dhe NATO-s pa bërë përparim në dialogun me Serbinë. Hovenieri në një takim me gazetarë ka thënë se kërkesat e ShBA-së për

shtensionimin e situatës në veri dhe dialogun me Serbinë nuk kanë të bëjnë me presion. "ShBA-ja ka një përkushtim të fortë afatgjatë ndaj popullit të Kosovës. Prandaj kërkojmë nga Kosova që tash për tash ta zbatojë marrëveshjen e Ohrit. Të

lëvizë shpejt, qëllimisht, për t'i çuar përpara negociatat për të krijuar një asociacion të komunave me shumicë serbe", ka thënë Hovenieri, duke shtuar se ShBA-ja pajtohet me kërkesën e BE-së për mbajtjen e zgjedhjeve të reja në veri

AKTUALE




KFOR-i THOTË SE DO TA RRISE LËVIZJEN E TRUPAVE DHE AUTOMJETEVE NË DITËT NË VIJIM

LIBURN ALIU TAKON ALI AHMETIN, DISKUTOJNË PËR RRUGËN PRIZREN - TETOVË

NDËRHYRJET E SHPESHTA NË GJYQËSOR, MIFTARAJ: E PAMUNDUR T'I NDJEK NDËRHYRJET E QEVERISË NË GJYQËSOR

EKONOMI



GËRHXHALIU: BIZNESET BARTIN INVESTIMET DHE PARATË E TYRE NË VENDE TË NDRYSHME EVROPIANE, POR NUK INVESTOJNË NË KOSOVË

INTERESIM I MADH PËR IZOLIMIN E KUSHTUESHËM TË SHTËPIVE

SPORT



BALLKANI ARRIN NË GJIBRALTAR, SONTE PËRBALLET ME LINCOLN

RRITEN RASTET ME MENINGJIT NË KOSOVË



HARADINAJ: ALBIN, A JE ME PROKURORIN A ME MUJECIN? BËHU I GJALLË!



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Turqia regjistron temperaturë rekorde

ANKARA, 16 GUSHT - Turqia ka regjistruar temperaturë rekorde prej 49.5-gradësh celsius teksa ekspertët kanë paralajmëruar se trendi i valës së të nxehtit në Mesdhe do të vazhdojë deri në vitet 2040. Temperatura rekorde është regjistruar të martën në provincën Eskishehër, ka thënë ministri turk i Ambientit, Mehmet Ozhasaki, në rrjetin social X. Sipas tij, rekordi paraprak është regjistruar më 2021 - 49.1 gradë celsius. Shërbimi Kombëtar i Motit ka paralajmëruar të mërkurën se vala e të nxehtit do të vazhdojë t'i rrisë temperaturat normale të sezonit për 11 gradë. Arsyeya kryesore mbrapa kësaj

vale besohet se qëndron te ndryshimet klimatike, ka thënë Baris Onol, profesor i meteorologjisë në Universitetin Teknik të Stambollit. Ndonëse fenomeni El Nino, që aktualisht është aktiv, ndikon në rritje të temperaturave, valët e të nxehtit janë bërë vitet e fundit më të shpeshta dhe më të gjata, ka thënë Onol për agjencinë e lajmeve dpa. "Turqia do të jetë më e ekspozuar ndaj temperaturave të larta në 30 deri në 40 vjetët e ardhshëm sikurse gjithë rajoni i Mesdheut", ka thënë Onol. Ai ka parashikuar që piku i sezonit turistik në të ardhmen do të bartet në shtator dhe tetor.



Ukraina e çliron nga forcat ruse një qytezë strategjike në Donjeck



KIEV, 16 GUSHT - Kievi ka thënë të mërkurën se forcat e saj e kanë çliruar vendbanimin Urozhaine, në rajonin industrial të Donjeckut, duke i vazhduar përpjekjet për t'i larguar forcat ruse nga jugu i Ukrainës. "Urozhaine u çlirua. Mbrojtësit tanë janë vendosur në periferi. Ofensiva vazhdon", tha zëvendësministria e Mbrojtjes e Ukrainës, Hanna Maliar, në një komunikatë në rrjetet sociale. Kievi e nisi kundëroftensivën e shumëpritur në qershor, por po përballet me beteja të forta pasi ka hapur në vështirësi për t'i thyer pozicionet e fortifikuara ruse. Njoftimi i Maliarit vjen një ditë pasi ministri i Mbrojtjes i Rusisë, Sergei Shoigu, tha se burimet e ushtrisë ukrainase "janë shterur

pothuajse", megjithëse po ndihmohet me armë nga aleatët perëndimorë. Moska nuk ka reaguar deri tani ndaj njoftimit të Ukrainës, e cila vazhdimisht ka tentuar ta hedhë poshtë rëndësinë e kapaciteteve luftarake të Ukrainës. Rajoni i Donjeckut, i cili e ka bartur barrën kryesore të luftimeve në muajt e fundit, është një nga katër rajonet e Ukrainës që Kremlin pretendo se i aneksoi vitin e kaluar, pak muaj pasi e nisi pushtimin në shkurt. Urozhaine, vendbanimi me një popullsi prej rreth 1 000 banorëve para luftës, është në mesin e një grumbulli qytezash që forcat ukrainase po tentojnë t'i marrin nën kontroll në javët e fundit.

Padia në Xhorxhia, sfida e katërt ligjore e Trumpit

WASHINGTON, 16 GUSHT - Donald Trumpi po përballet me probleme të reja ligjore. Një ditë më parë prokurorja e qarkut të Fultonit, Fani Willis, paditi ish-presidentin dhe 18 aleatë të tij, lidhur me përpjekjet për ta përmbytur rezultatin e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020 në shtetin e Xhorxhias. Kjo çështje penale është e katërta kundër ish-presidentit dhe e dyta këtë muaj, që pretendon se ai u përpoq të ndërhynte në zgjedhje. Xhorxhia ishte një nga shtetet ku Trumpi humbi ndaj rivalit demokrat Joe Biden me rezultat të ngushtë. Ish-presidenti Trump ka afat deri në mesditën e së premtes së javës së ardhshme, më 25 gusht, që të dorëzohet tek autoritetet në Atlanta. Trembëdhjetë akuzat në aktpadinë me 97 faqe kundër

Trumpit, përfshijnë shantazhin, shkeljen e betimit të presidentit, komplotin për të kryer falsifikim dhe për të paraqitur dokumente të rreme dhe shkelje të tjera. Në mesin e të akuzuarve janë edhe ish-shëfi i Shtëpisë së Bardhë, Mark Meadows, avokati personal i Trumpit, Rudy Giuliani dhe një zyrtar i Departamentit të Drejtësisë i administratës së Trumpit, Jeffrey Clark. "Çdo individ i akuzuar në këtë aktpadi akuzohet për pjesëmarrje në një sipërmarrje kriminale në bashkinë e Fultonit në Xhorxhia dhe në vende të tjera, për ta përmbytur qëllimin e jashtëligjshëm, për t'i mundësuar Donald Trumpit vjedhjen e mandatit presidencial, duke filluar nga 20 janari i vitit 2021", tha prokurorja e qarkut të Fultonit, Fani Willis. Akuza ngre pretendime të



shumta, duke përfshirë përpjekjen për t'i bindur ligjvënësit e Xhorxhias që të veprojnë kundër rezultatit të zgjedhjeve, të emërojnë një listë anëtarësh të kolegjit zgjedhor në favor të Trumpit dhe vjedhjen e të dhënave të votimeve.

Prokurorja Willis tha se caktimi i datës së gjyqit është në dorë të gjykatësit, por zyra e saj do të propozonte që gjyqi të zhvillohet në gjashtë muajt e ardhshëm. Akuzat vijnë pas hetimeve për dy vjet e gjysmë që buruan nga një telefonatë e regjistruar e Trumpit

në fillim të vitit 2021 me sekretarin e shtetit të Xhorxhias, Brad Raffensperger, në të cilën ai dëgjohet duke i kërkuar atij t'i "gjente" 11 780 vota, një më shumë se diferenca e fitores së presidentit Joe Biden në këtë shtet. Disa ditë më vonë, mbështetësit e Trumpit sulmuan Kapitolin në Uashington, në një përpjekje të pasuksesshme për t'i penguar ligjvënësit ta certifikonin fitoren e demokratit Joe Biden. Ekipi i ish-presidentit nuk priti zbardhjen e akuzave për të reaguar, duke e akuzuar prokuroren Willis se është një "partizane e tërbuar" që qëllimisht e ka zgjedhur kohën e hetimit të veprimeve të Trumpit, që të përkojë me zgjedhjet, duke ndërhyrë kështu në garën presidenciale të vitit 2024 dhe për ta dëmtuar fushatën e tij.

Mazreku: Urgjentisht të obligohet sigurimi i punëtorëve në ndërtimtari

PRISHTINË, 16 GUSHT - Vitet e fundit disa punëtorë në Kosovë kanë humbur jetën në vendet e tyre të punës. Një punëtor ka humbur jetën ditën e hënë në Prishtinë. Punëtori ka rënë nga një lartësi derisa ishte duke punuar.

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), Sami Mazreku, ka thënë se mungesa e sigurimeve të detyrueshme në vendet e

punës në Kosovë është një problem që mund të zgjidhet shumë lehtë, por duhet vendosmëri nga institucionet e Kosovës.

Mazreku ka thënë se sigurimi i punëtorëve duhet të obligohet me ligj dhe akte të tjera. Ai në një intervistë në emisionin e mëngjesit në RTK ka bërë me dije se më herët ka dorëzuar letra te kryetarët e komunave të Kosovës, që në kuadër të lejes

ndërtimore që e lëshojnë për kompanitë e ndërtimit, ato të obligohen edhe të blejnë një policë të sigurimit për punëtorë, që do të ishte një garanci për sigurinë e punëtorëve.

Drejtori Mazreku ka thënë se është i gatshëm të diskutojë për aktorët institucionalë që të gjejë zgjidhje për punëtorët në sektorin e ndërtimtarisë që ata të jenë të siguar.



Haradinaj: Albin, a je me prokurorin a me Mujecin? Bëhu i gjallë!

PRISHTINË, 16 GUSHT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka reaguar për arrestimin e zyrtarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Besnik Mujeci, i cili është arrestuar në Shqipëri nën dyshimet për shpërndarje droge. Haradinaj ka parashtruar një pyetje për kryeministrin Kurti, i cili është edhe lider i Lëvizjes Vetëvendosje.

"Albin, a je me prokurorin a me Mujecin? Bëhu i gjallë!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Mujeci, 40-vjeçar, është asamblist i Vetëvendosjes në Kuvendin Komunal të Prishtinës.

Të martën autoritetet shqiptare kanë thënë se Mujeci është në mesin e pesë të arrestuarve të cilët dyshohen se kanë

shpërndarë drogë të llojit ekstazi në lokalet e natës në zonën e ish-Bllokut në Tiranë, pasi kanë trafikuar lëndë narkotike nga Kosova në Shqipëri. Sipas autoriteteve të Shqipërisë, vlera e drogës me të cilën janë kapur të dyshuarit shkon në 400 mijë euro. Të arrestuarit e tjerë janë Mithat Ramadani, 30 vjeç, banor i Prishtinës, Kalem Picari, 24 vjeç, Ambra Myftari, 28 vjeçe dhe Daniel Avdija 26 vjeç, të tre banorë të Tiranës.

Të dyshuarit janë kapur me një dërgesë me lëndë të dyshuar narkotike prej 11 300 tabletave ekstazi MDMA, me peshë 5 093 kilogramë.

LV-ja ka njoftuar se e ka përjashtuar nga partia Besnik Mujecin.



Ndërrhyrjet e shpeshta në gjyqësor, Miftaraj: E pamundur t'i ndjekë ndërhyrjet e qeverisë në gjyqësor



PRISHTINË, 16 GUSHT - Drejtori i Institutit të Kosovës për Drejtësinë, Ehat Miftaraj, ka kritikuar ndërhyrjet e qeverisë aktuale në sistemin gjyqësor. Ai ka bërë me dije se në dy vitet e fundit edhe reagimit ndaj këtij fenomeni i ka humbur kuptimi. Në "Facebook" Miftaraj ka shkruar se është e pamundur ta ndjekë këtë qeveri me reagime për ndërhyrjet e shpeshta në pavarësinë e gjyqësorit të rregullt dhe në Gjykatë Kushtetuese. "Para disa viteve kemi reaguar në rastet kur politika përmes deklaratave politike ka cenuar pavarësinë e

sistemit gjyqësor, prokurorial apo të Gjykatës Kushtetuese. Dy vitet e fundit edhe reagimit i ka humbur kuptimi. Është e pamundur me ndjek këtë qeveri me reagime sa shpesh ndërhyjnë në pavarësinë e gjyqësorit të rregullt dhe Gjykatës Kushtetuese. Sidoqoftë, me krejt të metat që ka gjyqësori i rregullt dhe Gjykata Kushtetuese me plotë të drejtë dhe në mënyrë profesionale Gjykata Kushtetuese po e mbron Kushtetutën dhe strukturën e shtetit. Pushteti është i përkohshëm, shteti dhe vlerat që i garanton Kushtetuta duhet mbrojtur", ka shkruar Miftaraj.

Krasniqi: Për PDK-në prioritet është interesi nacional i vendit

PRISHTINË, 16 GUSHT - Në selinë e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi ka pritur në takim shefin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadorin Michael Davenport.

Ata kanë diskutuar për zhvillimet politike në Kosovë, me theks të veçantë për situatën në pjesën veriore të vendit. "Për PDK-në, sikur gjithmonë, interesi nacional i vendit dhe e ardhmja e sigurt

e qytetarëve tanë janë prioritet. Ambasadorin Davenport e falënderova për vizitën dhe kontributin e tij të çmuar në Kosovë!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".





AMBASADORI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) NË KOSOVË,
JEFFREY HOVENIER, MBAN TAKIM ME GAZETARË

Hovenieri thotë se kërkesat e ShBA-së ndaj Kosovës nuk janë presion

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se Kosova nuk mund të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian dhe NATO-s pa bërë përparim në dialogun me Serbinë. Hovenieri në një takim me gazetarë ka thënë se kërkesat e ShBA-së për shtensionimin e situatës në veri dhe dialogun me Serbinë nuk kanë të bëjnë me presion. “ShBA-ja ka një përkushtim të fortë afatgjatë ndaj popullit të Kosovës. Prandaj kërkojmë nga Kosova që tash për tash ta zbatojë marrëveshjen e Ohrit. Të lëvizë shpejt, qëllimisht, për t’i çuar përpara negociatat për të krijuar një asociacion të komunave me shumicë serbe”, ka thënë Hovenieri, duke shtuar se ShBA-ja pajtohet me kërkesën e BE-së për mbajtjen e zgjedhjeve të reja në veri

zbatimin e saj. Marrëveshja, prej 11 nënesh, nuk përfshin njohjen reciproke për të cilën insiston Kosova, por kërkon nga Kosova dhe Serbia t’i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë: pasaportat, diplomat dhe targat. Dokumenti kërkon nga palët që t’i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tash në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, përfshirë edhe atë për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, të cilin qeveria në Prishtinë e ka refuzuar deri më tash, me arsyetimin se mund ta rrezikojë funksionalitetin e shtetit. Në mesin e kërkesave të BE-së, por edhe ShBA-së, është që Kosova të mbajë zgjedhje të reja në komunat veriore.

“Jemi të interesuar ta shohim procesin që ecën përpara”

Ambasadori Hovenier ka thënë se mbajtja e zgjedhjeve në katër komunat veriore të banuara me shumicë serbe është një nga pikat që është identifikuar nga BE-ja si diçka që mund ta shtensionojë situatën në këtë

pjesë të vendit dhe se ShBA-ja pajtohet me këtë kërkesë. “Jemi të shqetësuar sa i përket situatës në veri të Kosovës dhe i kemi kërkuar qeverisë të marrë masa. I kemi kërkuar edhe Qeverisë së Serbisë të marrë masa për ta arritur shtensionimin në veri të Kosovës. Ne duam t’i shmangim trazirat, kërcënimet e dhunës dhe gjëra të tjera të cilat pengojnë aftësinë tonë për të punuar me palët për t’u fokusuar në objektivat strategjike, që është zbatimi i plotë i Marrëveshjes së Ohrit nga të dyja palët”, ka thënë ambasadori amerikan.

Më tutje, Hovenieri ka thënë se Kosova është zotuar se do t’i përmbushë pikat e rena dakord mes kryenegociatorit të Kosovës, Besnik Bislimi, dhe emisarit evropian Miroslav Lajçak, në Bratislavë, për shtensionimin e situatës në veri, dhe se ShBA-ja e mirëpret dhe e sheh këtë si hap pozitiv drejt shtensionimit. “Pyetja se si do të mbahen zgjedhjet në veri është pyetje e brendshme për Kosovën. Se a bëhet kjo, bëhet përmes dorëheqjes së kryetarëve të komunave, ose nëse bëhet përmes një procesi ku votuesit votojnë për t’i larguar kryetarët aktualë (peticioni)... Ne jemi të interesuar vetëm të shohim

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

PRISHTINË, 16 GUSHT - Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, në një takim me gazetarët të mërkurën në Prishtinë, ka thënë se kërkesat që Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) i kanë për Qeverinë e Kosovës nuk kanë të bëjnë aspak me presion. Ai ka thënë se Kosova, megjithatë, nuk do të mund t’i vazhdojë proceset integruese pa bërë përparim në dialogun me Serbinë. “Kosova nuk do të mund të bëhet anëtare e BE-së. Kosova nuk do të jetë në gjendje ta tejkalojë Partneritetin për

Paqe për t’u bërë anëtare e NATO-s - dy synimet themelore që ShBA-ja pret që ajo t’i realizojë - pa bërë përparim në dialogun e lehtësuar nga BE-ja”, ka thënë Hovenieri. Sipas tij, kërkesat nga Shtetet e Bashkuara dhe partnerët e tjerë janë legjitime, duke marrë parasysh mbështetjen që ShBA-ja i ka dhënë shtetit të Kosovës dhe se një nga synimet më të mëdha strategjike është “ta shohim Kosovën që ka zënë vendin e saj, duke mbështetur Kosovën të zërë vendin e saj në strukturat evropiane dhe euroatlantike”. “Si ambasador i Amerikës në Kosovë jam shumë rehat me atë që po kërkojmë nga Qeveria e

Kosovës që të bëjë atë që po kërkojmë nga populli i Kosovës. Nuk duhet të ketë asnjë dyshim dhe shpresoj se është shumë e qartë: ShBA-ja ka një përkushtim të fortë afatgjatë ndaj popullit të Kosovës. Prandaj, kërkojmë nga Kosova që tash për tash ta zbatojë marrëveshjen e Ohrit. Të lëvizë shpejt, qëllimisht, për t’i çuar përpara negociatat për të krijuar një asociacion të komunave me shumicë serbe”, ka thënë ambasadori Hovenieri. Hovenieri i është referuar Marrëveshjes Drejt Normalizimit të Raporteve që Kosova dhe Serbia kanë arritur në shkurt në Bruksel dhe në mars në Ohër dhe janë pajtuar për Aneksin për

Shtatë vjet më parë Thaçi e priti Bidenin në 'Adem Jashari': Partneriteti me ShBA-në na ka bërë shtet

PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Shtatë vjet më parë ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e pati pritur në Aeroportin "Adem Jashari" presidentin e tanishëm të ShBA-së, Joe

Biden, me familje. Thaçi kishte thënë se partneriteti strategjik me ShBA-në e ka bërë Kosovën shtet të pavarur dhe demokratik. "Partneriteti strategjik me ShBA-në na

ka mundësuar të bëhemi shtet dhe gjithnjë e më shumë po na bën një shoqëri demokratike me mundësi të barabarta për të gjithë", kishte thënë Thaçi.



Gërxfhaliu: Bizneset bartin investimet dhe paratë e tyre në vende të ndryshme evropiane, por nuk investojnë në Kosovë

PRISHTINË, 16 GUSHT - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxfhaliu, ka thënë se bizneset bartin investimet dhe paratë e tyre në vende të ndryshme evropiane, por nuk investojnë në Kosovë. "Mungesa e stabilitetit politik, mungesa e një qeverisje pro-biznes në Kosovë, mungesa e dialogut dhe partneritetit të mirëfilltë publiko-privat, mungesa e fuqisë punëtore dhe ikja e vazhdueshme e fuqisë punëtore jashtë Kosovës, masat ndëshkuese nga ana e BE-së ndaj Kosovës, mbyllja e kufirit në Merdar, trazirat në Mitrovicën e Veriut dhe situata shqetësuese në katër komunat në veri, një frymë antiamerikane dhe antievropiane që po dominon, një qasje jo miqësore ndaj sektorit privat dhe imazhi i dobët i Kosovës kudo si pasojë edhe e mungesës së diplomacisë ekonomike dhe



politike janë ndër arsyet që e shuajnë shpresën e bizneseve vendore për investime në

Kosovë", ka shkruar Gërxfhaliu në "Facebook". Sipas tij, sot bizneset e Kosovës investojnë

miliona në Mal të Zi, Slloveni, Austri, në veçanti në Gjermani dhe Zvicër. "Kur kemi parasysh

që edhe diaspora nuk gjen ambientin e volitshëm për investime në Kosovë, besoj se dëshmohet se situata ekonomike është alarmante! Jemi dëshmitarë se në Kosovë çdo gjë është politizuar dhe mungon vlera dhe profesionalizmi, por besoj se është koha për reflektim që të punohet për shtetin dhe qytetarët, jo vetëm për pushtetin e interesat partiake", ka thënë ai.

Gërxfhaliu ka thënë se inflacioni ka kapluar çdo produkt dhe shërbim. "Ngritja e çmimeve nuk ka ndalur dhe nuk ka kontroll, ndërsa pagat janë në nivel mizor, duke filluar nga 190 euro deri në 350 euro. Liria e Republikës së Kosovës është ëndërruar të jetë ndryshe dhe kjo, siç është sot, është pa shpresë, pa perspektivë dhe me të vetmen dëshirë për të ikur nga Kosova e lirë!", është shprehur Gërxfhaliu.

procesin që po ecën para", ka thënë Hovenieri, duke shtuar se ShBA-ja pret që serbët që jetojnë në veri, kësaj radhe të marrin pjesë në zgjedhje.

Duke folur për kryetarët aktualë të komunave në veri - të cilët ka thënë se ShBA-ja i njeh si të ligjshëm pa marrë parasysh mënyrën se si është zhvilluar situata më pas - ai ka theksuar se mendon se asnjë kryetar e zgjedhur me më pak se 4 për qind të votave "mund të ndihet se ka mandat gjithëpërfshirës".

Në Bratislavë, më 10 korrik, Kosova dhe BE-ja janë pajtuar për hapa drejt shtensionimit të tensioneve në veri, ku janë përfshirë edhe tërheqja e policisë dhe mbajtja e zgjedhjeve. Pas rritjes së tensioneve në veri të Kosovës, qeveria Kurti më 14 qershor ka vendosur ndalesë ndaj importit të mallrave serbe. Në këtë kontekst, Hovenieri ka përsëritur qëndrimin se Uashingtoni mbështet nisma që lehtësojnë lëvizjen e lirë të mallrave dhe njerëzve. "Pasi Kosova dhe Serbia aspirojnë integrimin evropian, të dyja shtetet duhet të ndërrojnë veprime për ta promovuar më shumë lëvizjen e mallrave përmes kufijve të tyre dhe jo hapa që pengojnë lëvizjen", ka thënë ai. Hovenieri ka thënë se ShBA-ja e

ShBA-ja nuk e mbështet as "Shqipërinë e Madhe" dhe as "Serbinë e Madhe"

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) nuk e mbështesin as "Shqipërinë e Madhe" dhe as "Serbinë e Madhe". Këtë qëndrim të Uashingtonit zyrtar e ka dhënë të mërkurën në Prishtinë ambasadori amerikan

Jeffrey Hovenier në një takim me gazetarë. Ai ka thënë se ShBA-ja e përkrah integritetin territorial dhe sovranitetin e çdo shteti në Ballkanin Perëndimor. Ky reagim i diplomatit vjen pas zhvillimeve që pasuan pas

vizitës së kryeministrit Albin Kurti, në Maqedoninë e Veriut, e cila ka nxitur reagime të bartësve të institucioneve për shkak të disa simboleve që promovonin shtetin etnik të shqiptarëve.

trajton si çështje serioze ndalesën e cila duket që po pret edhe importet me ilaçe dhe furnizime të tjera shëndetësore nga Serbia në Kosovë. Ai shtoi se, "si e kuptojmë ne, ilaçet dhe furnizimet e tjera shëndetësore janë importuar nga Serbia në Kosovë sikurse para 14 qershorit". I pyetur për një deklaratë të ministrit për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës, Nenad Rashedi, se Prishtina do ta anulonte vendimin për mallrat nëse Bashkimi Evropian do t'i hiqte masat ndëshkuese ndaj Kosovës, Hovenieri ka thënë: "ShBA-ja vazhdon ta inkurajojë Qeverinë e Kosovës që të ndërrojnë veprime që promovojnë lëvizjen e lirë të mallrave, pa referencë nëse BE-ja ndërrohet hapa ose jo. Unë do të

këshilloj që të mos lidhen veprimet e Qeverisë së Kosovës për këtë çështje me pritjet se çfarë BE-ja do të bëjë ose jo me ato që i cilëson si masa të përkohshme dhe të kthyeshme". Sa iu përket të drejtave të komuniteteve joshumicë që jetojnë në Kosovë, Hovenieri ka thënë se prioriteti i Uashingtonit është ajo që thuhet në Kushtetutë dhe Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, që Kosova është shtet shumetnik, ku ofrohet mbrojtja e nevojshme për komunitetet. "Besoj se disa nga këto komunitete janë të pakënaqura. Ata ndiejnë se nuk po marrin mbrojtjen ligjore dhe nganjëherë edhe respektin që po e kërkojnë brenda shoqërisë apo edhe nga qeveria. Pjesë e dialogut tonë me qeverinë dhe

organizata të shoqërisë civile se si mund ta ndihmojmë Kosovën që të jetë më e suksesshme në integrimin dhe që të gjithë qytetarët, pavarësisht etnisë së tyre, të ndiejnë se kjo është shtëpia e tyre, ku trajtohen me dinjitet, respekt dhe siguri. Ka pasur përparim në shumë fusha, por mendoj se ende ka shumë punë që duhet bërë", tha ambasadori amerikan.

"O'Brieni ka njohuri për Kosovën dhe Serbinë"

Ambasadori Hovenier ka folur edhe për nominimin e Jim (James) O'Brien në pozitën e ndihmësekretarit të Shtetit për Çështje Evropiane dhe Euroaziatike. Edhe pse ka thënë

se praktika është që të mos komentohet derisa ai ta marrë konfirmimin nga Senati amerikan, ambasadori Hovenieri ka thënë se shpreson që O'Brieni të zgjidhet në këtë post për t'i "avancuar qëllimet strategjike të ShBA-së në Kosovë. "E gjitha që mund të them është që presidenti (amerikan Joe) Biden beson se ka nominuar dikë që është shumë i aftë për këtë pozitë. Unë kam pasur kënaqësinë që në të kaluarën të punoj me zotin O'Brien për çështje të rajonit. Qartësisht ai ka shumë njohuri për rajonin dhe, po ashtu, ka njohuri dhe përvojë për Kosovën dhe Serbinë", ka thënë Hovenieri.

O'Brieni ka qenë pjesë e delegacionit amerikan gjatë negociatave në Rambuje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në vitin 1999. Ai ka shërbyer në dy administrata amerikane, si i dërguar special presidencial. Ai shërbeu si këshilltar i lartë i ish-sekretares amerikane të Shtetit, Madeleine Albright, dhe i dërguar presidencial për Ballkanin. Ndërsa nga viti 2022 punoi shef i Zyrës së Koordinimit të Sanksioneve, me gradën e ambasadorit, në Departamentin Amerikan të Shtetit.

Drejtoresha Kadriu vazhdon monitorimin e punimeve në institucionet shkollore

PRISHTINË, 16 GUSHT - Drejtoresha e Drejtorisë Komunale të Arsimit, Drita Kadriu, së bashku me stafin e saj, kanë realizuar një

vizitë në ShMLE "Hasan Prishtina", për t'i monitoruar përgatitjet teknike për fillimin e vitit të ri shkollor. Me këtë rast,

drejtoresha Kadriu është shprehur e lumtur që nga afër po monitorohen investimet e bëra nga DKA në disa institucione

shkollore, me ç'rast ka bërë me dije se kushtet dhe mjedisi për pritjen e nxënësve në shtator do të jenë të kënaqshme.



Siguria në Podujevë, stabile

PODUJEVË, 16 GUSHT - Nën udhëheqjen e kryetarit të komunës, Shpejtim Bulliqi, është mbajtur mbledhja e tretë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2023. Gjatë kësaj mbledhje u analizuan mbarëvajtja e rendit dhe qetësisë publike, rastet e dhunës në familje dhe situata e përgjithshme e sigurisë në komunën e Podujevës.

Lidhur me gjendjen e sigurisë në komunë komandanti i Stacionit Policor, Nijazi Jashari, raportoi se gjatë periudhës janar-qershor 2023 janë raportuar 174 raste të aksidenteve të trafikut, 1 vrasje, 4 tentim-vrasje, 37 kanosje, 34 raste dhunë në familje, 40 raste të vjedhjeve, 30 raste armë mbajtje pa leje, 202 arrestime dhe 4 468 tiketa të shqiptuara për kundërvajtje në trafik.

Përfaqësuesi i KFOR-it gjenden e përgjithshme të sigurisë në komunën e Podujevës e ka vlerësuar të qetë dhe stabile si dhe ka ritheksuar gatishmërinë e KFOR-it për ruajtjen dhe sigurinë e përgjithshme publike. Ndërsa lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës për masat dhe sensibilizimin e qytetarëve për pasojat nga zjarri gjatë periudhës së korrje-shirjeve, djegieve të pyjeve dhe vërshimeve, kanë folur zyrtari i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Kujtim Zhitia, si dhe drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Vigan Salihu, duke thënë se është përcjell në vazhdimësi situata në terren dhe në koordinim të ngushtë me Brigadën e Zjarrfikësve është intervenuar aty ku ka pasur nevojë.



Në Llapushnik e Fushticë të Ulët vendosen vendndaljet për autobus

DRENAS, 16 GUSHT - Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës në Drenas ka njoftuar se në kuadër të realizimit të punëve të planifikuara për vitin 2023 ka finalizuar projektin për

rregullimin dhe zgjerimin e vendndaljeve për autobus dhe mbulimin e tyre.

Ky projekt është realizuar në fshatin Llapushnik dhe Fushticë e Ulët dhe do të jetë në shërbim të

qytetarëve të këtyre vendbanimeve.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë ka njoftuar se do të vazhdojë realizimin e projekteve sipas planifikimit të drejtorisë.

Fillon aksioni për shenjëzimin vertikal të rrugëve të qytetit të Prizrenit

PRIZREN, 16 GUSHT - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka bërë me dije se ka filluar aksioni i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për shenjëzimin vertikal të rrugëve brenda qytetit, i cili projekt do të vazhdojë edhe në fshatra. Totaj ka thënë se shenjëzimi i

dukur përveç që ndihmon në orientim, është i rëndësishëm edhe për sigurinë e të gjithë pjesëtarëve në komunikacion. "Investimi në përmirësimin e infrastrukturës rrugore parasheh edhe sinjalizimin vertikal e horizontal të rrugëve", ka thënë Totaj.



Po bëhet transformimi i AMF-së në Topanicë

KAMENICË, 16 GUSHT - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka vizituar AMF-në në Topanicë, ku po bëhet transformimi i

objektit nga një gjendje jo e mirë në një ambient modern, të pastër dhe me kushte të nevojshme për stafin dhe pacientët. "Shëndeti është primar,

por në ambiente të tilla është e vështirë të shërohem. Prandaj puna jonë e radhës është në funksion të shëndetit tuaj", ka thënë Rahimaj.



KFOR-i thotë se do ta rrisë lëvizjen e trupave dhe automjeteve në ditët në vijim

PRISHTINË, 16 GUSHT - Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, ka njoftuar të mërkurën se do të ketë lëvizje të shtuar të trupave dhe automjeteve të saj në territorin e Kosovës gjatë ditëve në vijim për, siç tha, të kryer "procedura normale".

Në një komunikatë për media më 16 gusht, Forca Ndërkombëtare Paqeruajtëse tha se rritja e lëvizjes së trupave dhe automjeteve të KFOR-it brenda Kosovës është për shkak të procedurave normale të pranimit-dorëzimit të kontingjenteve.

KFOR-i shtoi se do të mbajë edhe ushtrime për testimin dhe mirëmbajtjen e kapaciteteve operacionale në mënyrë që të sigurohet niveli i njëjtë i stërvitjeve dhe gatishmërisë për të gjitha njësitë e ardhshme në terren. "Derisa këto stërvitje do të kryen në një mënyrë që të minimizohet pengimi dhe ndikimi në popullatën vendore,

ka mundësi të ketë vonesa në trafik dhe mund të shihen lëvizjet e ushtarëve. Prandaj, KFOR-i i këshillon shoferët të kenë vëmendje të posaçme nëse ndodhen afër kolonave të automjeteve ushtarake", ka njoftuar KFOR-i.

Sipas Marrëveshjes Ushtarako-Teknike të Kosovës, që i dha fund luftës në Kosovë, KFOR-i është përgjegjës për sigurinë e kufijve të territorit të Kosovës.

Ushtrimet e KFOR-it vijnë pak muaj pasi dhjetëra ushtarë të tij u lënduan gjatë një përleshjeje me protestuesit serbë pas përshkallëzimit të dhunës në fund të majit, kur serbët kundërshtuan hyrjen në ndërtesat komunale të kryetarëve të rinj shqiptarë të Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut.

Dhuna e detyroi NATO-n të angazhojë 700 trupa shtesë në Kosovë, përveç 4 000 trupave që veçse janë në këtë shtet.



Rriten rastet me meningjit në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 GUSHT - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve dhe parandalimit të infeksioneve të ndryshme, bazuar në raportin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), ka kërkuar rritjen e vigjencës sa i përket kontrollit të vazhdueshëm të ujit të pijshëm dhe klorizimit të tij, kontrollit të shtuar dhe klorizimit të ujit të pishinave. "Bazuar në raportin e ShSKUK-së, numri i rasteve të raportuara për sindromën meningjeale gjatë muajit korrik-gusht, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ka shënuar rritje. Meningjiti mund të prekë këdo që bie në kontakt me agjensin, por disa grupmosha janë më të rrezikuara. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, meningjiti prek më së shumti moshat e reja ngaqë sistemi imunitar te personat e rinj,



kryesisht foshnjat, fëmijët dhe adoleshentët, nuk është zhvilluar mjaftueshëm për t'i luftuar agjentët", ka njoftuar

MSh-ja, duke theksuar se shkaktar i sindromës meningjeale janë infeksionet bakteriale ose virale. "Ndërsa si

rrugë e përhapjes së infeksionit mund të jenë pishinat, vendet e freskimit, kontakti dhe uji për pije", ka njoftuar MSh-ja.

Simptomat

Disa nga simptomat e sëmundjes janë të ngjashme me ato të një gripi normal, por që rëndohen për një kohë shumë të shkurtër. Meningjiti mund të shfaqet menjëherë ose 3-7 ditë pas marrjes së infeksionit.

Te simptomat e sëmundjes përfshihen: të vjella, marramendje, temperaturë e lartë e trupit, dhimbje e muskujve, ndjeshmëri ndaj dritës, dhimbje e kokës, konfuzion, gjymtyrë të ftohta, skuqe e lëkurës.

Ndërsa te fëmijët mund të ketë edhe simptoma si frymëmarrja e shpejtuar, irritim dhe të qara për një kohë të gjatë, humbje të përqendrimit dhe mungesë oreksi.

Sapo të 'iëreni simptomat e mësipërme apo gjendje të rënduar shëndetësore, duhet menjëherë të konsultoheni te mjeku.

Meningjiti trajtohet vetëm në spital.

Krasniqi: Vizita e Kurtit vetëm në Çair e Tetovë ka lënë shije të keqe

PRISHTINË, 16 GUSHT - Profesori universitar Milazim Krasniqi ka theksuar se rruga Prizren - Tetovë mund të bëhet vetëm me bashkëpunim të dy qeverive qendrore. Ai ka shkruar në "Facebook" se komunat nuk kanë buxhet e as kompetencë që të financojnë projekte të tilla. Krasniqi ka theksuar se vizita e Kurtit vetëm në Çair e Tetovë ka lënë shije të keqe

dhe ka qenë mesazh i keq sa i takon bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve. "1. Rruga Prizren - Tetovë mund të bëhet vetëm me bashkëpunim të dy qeverive qendrore. 2. Komunat nuk kanë buxhet e as kompetencë të financojnë projekte të tilla. 3. Për projekte të tilla duhet të konsultohet edhe Banka Botërore. 4. Vizita e Kurtit vetëm në Çair e Tetovë ka

lënë shije të keqe dhe ka qenë mesazh i keq sa i takon bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve. 5. Presionet e tashme të organeve të drejtësisë ndaj organizatorëve të asaj vizite dëshmojnë se Kurti me veprimet e veta mund t'u bëjë sherr shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, por nuk mund t'u ndihmojë asgjë", ka shkruar Krasniqi.



Interesim i madh për izolimin e kushtueshëm të shtëpive



Sa i rëndësishëm është izolimi i shtëpive?

Në një hulumtim të realizuar nga Instituti për Politika Zhvillimore në Prishtinë (INDEP) vlerësohet se izolimi ndërtimor mbetet një nga faktorët më të rëndësishëm në rritjen e efijencës së energjisë dhe performancës energjetike të objekteve. Me kosto relativisht të ulët, efijencia elementare e energjisë, sipas INDEP-it, arrihet përmes izolimit të jashtëm, vendosjes së dritareve dy dhe treshesore, si dhe izolimit të kulmit.

Në Kosovë, sipas hulumtimit të INDEP-it, një numër i madh i objekteve mbetet pa izolim, gjë që çon në shpenzime të mëdha të energjisë, duke detyruar familjet ta konsumojnë katërfishin e energjisë që konsumon një mesatare evropiane në një vit. “Me marrjen e disa masave minore izoluese, ky paraqet edhe potencialin më të lartë për masat dhe dobi të efijencës së energjisë jo vetëm në aspektin financiar, por edhe në atë mjedisor”, thuhet në hulumtimin e INDEP-it.

PRISHTINË, 16 GUSHT - Naim Pacolli nga fshati Marec i Prishtinës është duke shqyrtuar mundësinë që të aplikojë për subvencion nga qeveria për izolimin e shtëpisë së tij, pasi me mjete vetjake nuk ka mundur ta bëjë këtë investim. Ai tregon për “Radion Evropa e Lirë” se 11 vjet më parë e kishte ndërtuar shtëpinë, por izolimi termik i mureve të jashtme të shtëpisë atëbotë për të ishte i papërbalueshëm. “Në atë kohë izolimi i jashtëm i mureve të shtëpisë më kushtonte diku 8 000 euro dhe nuk e kam bërë se ishte shtrenjtë për mua”, thotë ai. Më 8 gusht Qeveria e Kosovës ka hapur thirrjen publike për aplikim për masa të efijencës së energjisë për shtëpitë individuale të banimit. Qeveria do të subvencionojë rreth 2 000 familje deri në 50 për qind të kostos së investimit, e kufizuar në shumën prej 5 500 eurosh. Ky subvencion përfshin koston e izolimit të jashtëm të shtëpisë, ndërrimin e dritareve dhe të derës së hyrjes si dhe izolimin e kulmit. Për këtë projekt janë ndarë gjithsej 10 milionë euro.

Projekti mbështetet nga Bashkimi Evropian, në kuadër të programit IPA [Instrumenti i Paraanëtarësimit] - Pako për Mbështetjen e Energjisë, i aranzhuar nga Qeveria e Kosovës dhe i zbatuar nga Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë (FKEE).

Për Pacollin, i cili punon në një kompani private, subvencioni i qeverisë është i pamjaftueshëm, pasi me të ardhurat mujore të tij prej 400 eurosh në muaj, e ka të vështirë ta sigurojë pjesën tjetër të mjeteve. “Është dashur që subvencioni të jetë 70 ose 80 për qind dhe të ketë kategorizime, për shembull për qytetarë me të ardhura më të ulëta subvencioni të jetë më i lartë. Për ata qytetarë që qëndrojnë mirë në aspektin financiar, kjo shumë është e mirëseardhur dhe e mjaftueshme, për ne me të ardhura të ulëta është pak”, thotë ai.

Sa kushton izolimi i shtëpisë?

Kusht i detyrueshëm për të përfituar nga subvencioni i qeverisë është izolimi termik i mureve të jashtme të

shtëpisë.

Çmimet në treg për shërbime të tilla janë të ndryshme.

Mirsim Selmani nga një kompani private e cila merret me izolim të mureve të jashtme të shtëpisë thotë për “Radion Evropa e Lirë” se çmimet i dikton kualiteti i materialit izolues. Sipas tij, një metër katror për izolim termik të mureve të jashtme të shtëpisë kushton nga 20 euro deri në 24 euro, varësisht nga materiali që përdoret.

Krahasuar me dy-tre vjetët e kaluar, ai thotë se tani çmimet janë më të larta. “Ka pasur rritje të çmimeve për 20 për qind, materialet janë shtrenjtuar, kostoja e fuqisë punëtore është rritur”, thotë ai.

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se indeksi i tërësishëm i kostos së ndërtimit ka pësuar rritje për 3.3 për qind në tremujorin e parë të vitit 2023 krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2022.

Selmani thotë se që nga hapja e aplikimit për subvencion është rritur interesimi për izolim të jashtëm të mureve të shtëpive. “Para tre-katër ditëve kemi pasur 10 kërkesa për izolim të shtëpive”, thotë ai.

Mbi 1 000 aplikime të qytetarëve për izolim të shtëpive

Fillojëta Konjuhi, specialiste për marrëdhënie me publikun në Fondin e Kosovës për Efijencë të Energjisë, thotë për REL-in se vetëm brenda një jave kanë pranuar mbi 1 000 aplikime. Aplikimet, thotë Konjuhi, po trajtohen mbi bazën kush vjen i pari shërbehet i pari. “Ka interesim të madh të qytetarëve për subvencion. Ne kemi filluar t’i shqyrtojmë aplikimet. Komisioni do t’i verifikojë të gjitha. Në momentin që aplikuesi i përmbush kushtet, përfituesi pranon një letër aprovuese me të cilën ai mund të fillojë t’i kryejë punimet”, thotë Konjuhi.

Të drejtë aplikimi për të përfituar nga ky subvencion kanë të gjithë qytetarët të cilët i përmbushin kriteret e përcaktuara nga FKEE-ja.

Aplikimi do të jetë i hapur deri më 25 shtator 2023. Por, aplikimi mund të mbyllet edhe para kësaj date në rast se arrihet kuota e buxhetit në dispozicion.

Rëndësia e kursimit të energjisë

Statistikat tregojnë se më së shumti energji elektrike në Kosovë shpenzon sektori i amvisërisë - rreth 40 për qind të konsumit të përgjithshëm.

Kosova nuk arrin ta plotësojë të gjithë kërkesën për furnizim me rrymë nga gjenerimi i brendshëm i energjisë elektrike.

Vendi ka kapacitet të prodhojë rreth 800 megavatë rrymë në orë, ndërsa nevojat e saj, në ditë dimri, arrijnë deri në 1 300 megavatë në orë. Kjo diferencë importohet nga jashtë. Vitin e kaluar Kosova u përfshi në një krizë energjetike. Qeveria vendosi masa emergjente për energji, të cilat përfshijnë masa të kursimit të energjisë elektrike nga të gjitha institucionet.

Nga 1 prilli i këtij viti në Kosovë kanë hyrë në fuqi tarifat e reja të energjisë elektrike, me rritje prej 15.4-përqindësh për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

Liburn Aliu takon Ali Ahmetin, diskutojnë për rrugën Prizren - Tetovë

TETOVË, 16 GUSHT - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, së bashku me zëvendësmministrin Hysen Durmishi, janë takuar në Tetovë me zëvendëskryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi dhe kryetarin e BDI-së, Ali Ahmeti. “Patëm një

bashkëbisedim të shkëlqyer, për rëndësinë e bashkëpunimit, rifuqizimin e lidhjeve historike e kulturore, dhe bashkëpunimin e ndërsjellë për projekte në dobi të të gjithë shqiptarëve. Mes të tjerash, biseduam për projektin shumë të rëndësishëm infrastrukturor rrugor

që do ta lidhë Prizrenin me Tetovën, si dhe për hapat e mëtejshme për finalizimin e marrëveshjes financiare. Bashkërisht u zotuar që këtë projekt të përbashkët ta realizojmë sa më parë. Jemi bashkë për rrugët që na bëjnë bashkë!”, ka shkruar ministri Aliu.



Shqipëri, bumi i ndërtimeve nuk jep shenja ngadalësimi



Migrimi drejt qendrave urbane, remitancat nga diaspora shqiptare dhe rindërtimi pas tërmetit e kanë bërë prej kohësh ndërtimin një nga sektorët më të mëdhenj të ekonomisë shqiptare. Ndërsa turizmi rritet në nivele të paprecedentë, bumi do të vazhdojë.

Vizitorët në Shqipëri këtë verë mund të falen, nëse mendojnë se vendi mbetet një vepër në progres. Sheshet e ndërtimit dominojnë peizazhin, nga malet e veriut dhe lindjes deri në vendpushimet e plazheve të jugut dhe perëndimit. Të dhënat mbështesin këto përshtypje të dëshmitarëve okularë. Në vitin 2022, industria e ndërtimit përbënte 11.2 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) të Shqipërisë – pjesën më të madhe në ekonominë e çdo vendi në Evropë dhe Azinë Qendrore.

Në tremujorin e katërt të vitit të kaluar, ndërtimi dhe kontributin më të madh pozitiv (+1,69 për qind) në rritjen prej 4,73 për qind të PBB-së. Sektori i ndërtimit është një nga sektorët më të mëdhenj të ekonomisë dhe është një burim jetik punësimi, duke zënë tetë për qind të fuqisë punëtore.

Rëndësia e ndërtimit në ekonominë shqiptare nuk është e re, ndërkohë që forca të njëpasnjëshme dhe komplementuese, kanë kontribuar në ruajtjen e peshës së tij.

“Që nga shembja e komunizmit, industria e ndërtimit në Shqipëri është shfaqur si një shtytës kryesor i rritjes së saj ekonomike,” thotë për “Emerging Europe”, Dr Ravik Mima, autor në Institutin e Vjenës për Studimet Ekonomike Ndërkombëtare. “Rritja fillestare në këtë sektor u nxit nga një nevojë e vërtetë për strehim, veçanërisht në zonat urbane, një prirje e nxitur nga migrimi i popullsisë nga zonat rurale.”

Kur ra komunizmi në vitin 1991, Shqipëria ishte ndër vendet më të varfra në rajon dhe pa një eksod masiv të shqiptarëve nga zonat rurale, teksa kërkonin mundësi ekonomike në kryeqytet, Tiranë dhe jashtë saj.

“Për dy dekadat e para, ndërtimi privat lulëzoi, i mbështetur kryesisht nga të ardhurat dhe kursimet në rritje të banorëve, të shtuara nga ndërmjetësimi i fuqishëm financiar i ofruar nga

sektori bankar,” thotë Dr Mima. “Përveç kësaj, remitancat nga brezi pionier i emigrantëve postkomunistë kontribuan ndjeshëm në këtë rritje.”

Tirana u rrit me shpejtësi dhe vazhdon të rritet me 30,000 njerëz çdo vit, duke krijuar zgjerim të padëshiruar dhe një nevojë të përhershme për më shumë banesa. Nisma Tirana 2030 synon të ndalojë zgjerimin, duke ripërqëndruar ndërtimin në zemrën e qytetit.

Megjithatë, kriza ekonomike e vitit 2008 çoi në një periudhë maturimi dhe rënije të sektorit pasi bizneset u larguan nga një treg që dukej i ngopur. Ndërtimi arriti nivelin më të ulët në vitin 2013. Megjithatë, që atëherë, kërkesa e ripërtërirë për ndërtime banesash ka rikthyer rritjen në sektor—ndihmuar me mbi një miliard euro nga buxheti i shtetit midis viteve 2020 dhe 2022, të përdorura për projektet e rindërtimit, si pasojë e një tërmeti në vitin 2019.

Në vitin 2020, gjysma e totalit të investimeve vendase u përqëndrua në strehim, krahasuar me një të katërtën në vendet e

tjera të Ballkanit. “Shumica e ndërtimeve të reja përfshijnë ndërtesa banimi në qytetet kryesore si Tirana, Durrësi, Elbasani, Korça dhe Vlora,” thotë Andi Memi, një partner në Hoxha, Memi dhe Hoxha, një studio ligjore. Ndërtesat e banimit përbënin 42,7 për qind të vlerës së lejeve të ndërtimit të lëshuara në tremujorin e parë të vitit 2023, ndërsa ndërtesat jorezidenciale zënë 42,3 për qind dhe pjesa tjetër janë të inxhinierisë civile.

Rritja e turizmit

“Sidoqoftë,” vëren Dr Mima, “në vitet e fundit, shtysa që nxit sektorin e ndërtimit ka evoluar. Së pari, një tendencë e re është shfaqur midis familjeve të pasura, si rezidentë dhe jorezidentë—duke përfshirë jo vetëm diasporën shqiptare por edhe investitorët e huaj—të cilët po tregojnë një prirje në rritje për të zotëruar shtëpi të shumta si asete investimi në një treg banesash në lulëzim.

Së dyti, sektori i turizmit, pasi ka pësuar rritje të konsiderueshme gjatë dekadës së fundit dhe duke treguar potencial premtues për

zgjerim të mëtejshëm, ka nxitur projekte ndërtimi jorezidenciale si hotele dhe rezorte,” shton Dr Mima.

Viti i kaluar pa një rritje prej 48.5 për qind krahasuar me vitin 2021, në të ardhurat nga ardhjet e turistëve dhe turizmi përbënte 15.8 për qind të PBB-së. Rreth 7.5 milionë turistë të huaj vizituan vendin me 2.8 milionë banorë në vitin 2022, por me një rritje prej 35 për qind të turistëve në periudhën janar-prill 2023, vendi pret të presë të paktën dhjetë milionë njerëz këtë vit.

Fluturimet për në Tiranë nuk janë gjithmonë të lira dhe shumë vizitorë fluturojnë në vendet fqinje dhe hyjnë në Shqipëri me autobus ose traget. Kjo do të ndryshojë në tetor, kur Ryanair do të shtrihet edhe në Tiranë, duke nisur 96 fluturime low cost në javë, në 17 linja.

Teksa edhe më shumë vizitorë që priten në malet, fshatrat dhe rivierën e Detit Jon në vitin 2024, turizmi duket se do të vazhdojë të rritet dhe, nga ana tjetër, të nxisë më tej ndërtimin. / “Emerging Europe” – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Ballkani arrin në Gjibraltar, sonte përballet me Lincolnin

PRISHTINË, 16 GUSHT - Skuadra kampione e Kosovës, Ballkani, ka zbarkuar të mërkurën në Gjibraltar. Sot do ta zhvillojë ndeshjen kthyesë

të rrethit të tretë kualifikues të Ligës së Evropës. Suharekasi e drejtuar nga trajneri Ilir Daja e fituan lojën e parë në Prishtinë me rezultat 2-0 ndaj Lincoln

Red Imps FC. Kampionët e Kosovës janë të motivuar edhe për ndeshjen e kthimit dhe synojnë të kualifikohen në fazën e "play-off"-it të kësaj gare. Në anën tjetër

skuadra vendase e Lincoln Red Imps kërkon ta përmbysë rezultatin e ndeshjes së parë dhe të kualifikohet tutje. Ndeshja fillon në orën 18:00.



City fiton për herë të parë Superkupën e Evropës

MANCHESTER, 16 GUSHT - Manchester City fiton për herë të parë Superkupën e Evropës në historinë e saj. Ekipi i Guardiols triumfoi në finalen e madhe të luajtur në Pire falë ruletës së penalltive, pasi koha e rregullt do të mbyllej në barazim 1-1.

Sevilla befasoi Cityin e Guardiols duke kaluar në avantazh në minutën e 26-të. Pas një krosimi të bukur, En-Nesyri është në vendin dhe në kohën e duhur për të devijuar topin në rrjetë.

City hasi shumë vështirësi në 45

minutat e para duke i mbyllur në disavantazh. Në fillimin e së dytës, kampionët e Evropës do të gjenin dhe barazimin. Në minutën e 63-të, Rodri jep një pasim fantastik në zonë atje ku talenti Palmer e shfrytëzon më së miri duke lënë të shtangur portierin Bono. Në minutat në vijim City është më dominues me disa mundësi të mira shënimi, por Bono dhe fati ishin në anën e iberikëve. Sfidat shkojnë te ruleta e penalltive, atje ku do të fitonte City 5-4, falë një gabimi të Gudeljt.



Sylvinho: Broja nuk do të grumbullohet ndaj Çekisë dhe Polonisë

TIRANË, 16 GUSHT - Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Sylvinho, ka nisur punën për dy ndeshjet e muajit shtator. Sa të rëndësishme po aq të vështira janë përballet me Çekinë fillimisht në transfertë dhe më pas me Poloninë në "Air Albania". Strategu brazilian ka bërë me dije se Armando Broja nuk do të grumbullohet për dy ndeshjet e ardhshme kualifikuese në Kampionatin Evropian. "Broja? Jemi duke marrë disa informacione për të. Si federatë shqiptare kemi komunikuar me Chelsea përpara se të dërgojmë një ftesë në klub. Lajmi që kemi është se Chelsea ka një protokoll për Brojen pasi vjen nga një dëmtim i gjatë dhe nuk është e lehtë të vijë. Unë kam folur edhe



me lojtarin dhe duhet të respektojmë këtë moment mes federatës dhe Chelsea. Përgjigjja e Departamentit Mjekësor të Chelsea nuk është e mirë, ka një protokoll dhe sigurisht se do të duhet të vlerësohet. Grumbullimi

do të jetë më 29-30 gusht, por nuk do të jetë e lehtë. Sipas meje dhe sipas londinezëve, në këtë moment Broja nuk është në gjendje të vijë në Kombëtare", u shpreh Sylvinho për "Panorama Sport".

Më 16 shtator fillon kampionati i ri i hendbollit

PRISHTINË, 16 GUSHT - Bordi i Federatës së Hendbollit të Kosovës, nën udhëheqjen e presidentit Eugen Saraçini, ka mbajtur mbledhjen e radhës, në të cilën ka diskutuar dhe vendosur për çështje të rëndësishme në prag të edicionit të ri garues. Në këtë mbledhje është vendosur që Superliga e hendbollistëve në edicionin 2023/2024 të ketë tetë skuadra. Drita e Gjilanit dhe Llapi kanë hequr dorë nga paraqitja në Superligë dhe do të garojnë në Ligën e Parë. Gara do të zhvillohet në sistem të katërfishtë e më pas plejofi. Në Superligën e hendbollistëve numri i skuadrave dhe sistemi garues nuk ka ndryshuar nga edicioni i kaluar. Ndërkohë kampionati i ri në të dy konkurrencat fillon më 16 shtator.



Një javë para fillimit të kampionatit zhvillohet Superkupa e Kosovës në hendboll. Bordi, po ashtu, vendosi që skuadrat që garojnë në Evropë të përkrahen me nga 1 000 euro shtesë.

Rashica në Stamboll: Jam i lumtur që jam këtu

STAMBOLL, 16 GUSHT - Milot Rashica është futbollisti më i ri i skuadrës së Beshiktashit. Ylli i "dardanëve" është prituri si hero dhe me

brohoritje nga disa tifozë të klubit bardhezi. "Jam mjaft i lumtur. Jam mjaft i ngazëlluar që jam këtu", ka thënë Rashica. Mediet turke

kanë raportuar se Beshiktashi do t'i paguajë 5 milionë euro për kartonin e futbollistit vushtrrias. Ish-anëtari i Norwich Cityt pritet

të nënshkruajë kontratë katërvjeçare me klubin turk, deri në qershor 2027, ndërsa pritet të paguhet 2 milionë euro në vit.



Deco emërohet drejtor i ri sportiv te Barça

BARCELONË, 16 GUSHT - Barcelona e ka emëruar ish-mesfushorin Deco në pozitën e drejtorit të ri sportiv, kurse e ka konfirmuar largimin Mateu Alemany. Alemany do të punojë me

Decon për pjesën e mbetur të afatit kalimtar, por jo më shumë. "FC Barcelona dhe Anderson Luis de Souza 'Deco' kanë arritur një marrëveshje në lidhje me bashkimin e tij në

klub. Lojtari i ekipit të parë midis viteve 2004 dhe 2008 nënshkroi një kontratë si drejtor sportiv në klub për tre sezonet e ardhshme. Deco do të jetë përgjegjës për përcaktimin

e filozofisë sportive të FC Barcelona dhe për ta bashkuar skuadrën me trajnerin dhe do të bëhet shef i seksionit të futbollit", thuhet në njoftimin e Barcelonës.



Drejtori i Ferrarit: Do të marrim mekanikë të rinj, pilotët mund të bëjnë më mirë

MARANELLO, 16 GUSHT - Ferrari nuk ka mundur t'i përmbushë pritshmëritë as në këtë sezon të Formulës 1 teksa kur është zhvilluar thujse gjysma e kampionatit, kokëkuqja po vuan dhe është shumë larg Red Bullit të Max Verstappenit. Drejtori i Ferrarit, Frederic Vasseur, shprehet se nga sezoni i ardhshëm, skuadrës do t'i shtohen të tjerë mekanikë, ndërsa nuk la pa "thumbuar" edhe pilotët Charles Leclerc e Carlos Sainz për të cilët tha se pritet më shumë. "Nuk i prisim të tilla rezultate, por e kishim të qartë nga momenti i parë kur zbritëm në pistë. Por, i rëndësishëm është reagimi i skuadrës. Njerëzit mendojnë se në Formula 1 problemet zgjidhen brenda javës, por nuk është kështu. Do të sjellim mekanikë të rinj, por kjo puna e mekanikëve është pak a shumë si merkato e futbollistëve. Ata më të spikaturit kanë kontratë trevjeçare dhe është e vështirë për t'i marrë. Me pak fjalë është e komplikuar", ka thënë Vasseur. "A e kemi kuptuar pse kjo makinë nuk është fituese? Në prova



makina nuk është keq, por në garë është pak e vështirë ta mbash ritmin. Në prova mund të bësh një xhiro të mirë dhe të shkosh në limite, por në garë është ndryshe. Është një problem aerodinamik. Pilotët? Gjithmonë mund të bëhet më mirë. Leclerc duket sikur është përmirësuar në

garat e fundit, ndërsa Sainz ka vazhdueshmërinë dhe për ne është i besueshëm. Leclerc është një karakter pak më i vështirë pasi nuk përmbahet kur gjërat nuk shkojnë mirë, por ndonjëherë për të mirën e tij dhe të skuadrës duhet të qetësohet para se të japë deklarata", ka deklaruar Vasseur.

Presidenti i PSG-së: E vështirë ndarja me një legjendë

PARIS, 16 GUSHT - Neymari është larguar nga PSG-ja pas gjashtë vjetësh dhe i është bashkuar Al Hilalit. Presidenti i klubit francez, Nasser Al Khelaifi, e ka quajtur Neymarin "legjendë" të klubit pas shitjes së tij tek Al Hilali. Superylli brazilian mbetet transferimi më i shtrenjtë në historinë e futbollit botëror me një kosto prej 222 milionë eurosh dhe pas pesë titujve të ligës dhe një finale të Ligës së Kampionëve, ndër të tjera, presidenti francez Nasser Al Khelaifi i tha lamtumirë sulmuesit 31-vjeçar me një deklaratë. "Sigurisht që është e vështirë t'i thuash lamtumirë një legjende të klubit. Nuk do ta harroj kurrë ditën kur erdhi në Paris, as atë që sollim në klub dhe në projekt gjatë këtyre gjashtë viteve. Do të jetë gjithmonë pjesë e historisë sonë.



Dua ta falënderoj atë si dhe familjen e tij. I uroj Neymarit më të mirat për të ardhmen", ka deklaruar Al Khelaifi. Neymar kishte kontratë deri në vitin 2025 në Paris, por ai kërkoi të largohej

dhe klubi nuk e bllokoi, pasi marrëdhënia mes dy palëve ishte prishur prej kohësh. Neymar regjistroi 173 paraqitje për klubin francez dhe shënoi 118 gola dhe 77 asistime.

SHKURT

Hamza Jashari fiton gradën 'Mjeshtër i xhudos'

Trajneri Driton Kuka ka njoftuar se Hamza Jashari e ka fituar gradën "Mjeshtër i Xhudos". Jasharin me këtë gradë e vlerësoi komisioni për breza, i cili përbëhet nga Driton Kuka, Majlinda Kelmendi dhe Fatos Tabaku. "Nder dhe privilegj që sot u gradua nga Federata jonë para komisionit për breza ku ishim unë, Majlinda dhe Fatosi. E vlerësuam Hamza Jasharin me gradën 'Mjeshtër i xhudos'. Urime Hamzë titulli i Mjeshtërit", ka shkruar Kuka në "Facebook".

Messi dhuron 'show', Interi Miami në finalen e Kupës së Ligës

Lionel Messi nuk ndalet në aventurën e tij të re në Shtetet e Bashkuara të Amerikës duke kualifikuar Inter Miamin në finalen e Kupës së Ligës. Ylli argjentinas kontribuoi në fitoren e ekipit të tij ndaj Philadelphia Unionit me shifrat 4-1. Gjithashtu, për Inter Miamin arriti të realizojë dhe transferimi i verës, Jordi Alba. Në gjashtë sfidat e para të luajtura me fanellën e klubit amerikan, Messi ka arritur të realizojë nëntë gola. Me fitoren e korrur ndaj Philadelphia Unionit, Inter Miami tashmë do të përballet në finalen e Kupës së Ligës përballë Nashville SC.

Roma paraqet Paredesin dhe Sanchesin

AS Roma ka bërë zyrtare sot dy transferime, ku pas Leandro Paredes edhe Renato Sanches i bashkohet skuadrës së Jose Mourinhos. Mesfushori 29-vjeçar i është bashkuar Romës në një marrëveshje permanente nga Paris Saint-Germaini. Paredes ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me "Giallorossët", me opsionin për ta rinovuar edhe për një vit tjetër, e cila do ta mbajë atë në "Olimpico" deri më 30 qershor të vitit 2025. Klubi italian do t'i paguajë PSG-së katër milionë euro për Paredes. Gjithashtu, Roma ka bërë zyrtare transferimin e Renato Sanches nga i njëjti klub në një marrëveshje huazimi me obligimin për ta bërë transferimin permanent nëse disa kushte arrihen. Mesfushori 25-vjeçar ka luajtur për Benficën, Bayern Munchenin, Swansea dhe Lillen.

Ziyech transferohet në Turqi

Galatasaray ka siguruar një përforcim nga Chelsea. Bëhet fjalë për Hakim Ziyech, i cili karrierën do ta vazhdojë në Turqi. 30-vjeçari aktivizohet me Chelsea prej vitit 2020. Në janarin e këtij viti ishte afër kalimit te PSG-ja, por akordi final nuk u finalizua për shkak të një problemi në komunikimin mes dy klubeve. Gjatë verës u afrua me Al Nassrin në Arabinë Saudite, por transferimi nuk u realizua për një problem fizik të "xholit" ofensivë. Galatasaray do të jetë skuadra e pestë në karrierën e Ziyech pas Chelsea, Ajaxit, Twentes dhe Hereenveinit.

De Ligti: Bayerni ende ka shumë probleme për të zgjedhur

Mbrojtësi i Bayern Munchenit, Matthijs de Ligt, ka thënë se skuadra kampione e Gjermanisë ende ka shumë probleme për të zgjedhur. Deri te këto komente mbrojtësi holandez erdhi pasi

Bayerni e humbi finalen e Superkupës nga Leipzig (0-3). "Hymë në ndeshjen e parë të rëndësishme të sezonit në mënyrën më të keqe dhe menjëherë bëmë shumë gabime

në mbrojtje, në të njëjtën kohë nuk shfrytëzuam asnjë rast në sulm. Unë mendoj se ndoshta ato që na u dukën pozitive në miqësoret e verës, në fitoret me Monacon dhe Liverpoolin kanë

qenë një gënjeshtëri. Dhe është normale që asnjëherë rezultateve të miqësoreve nuk duhet t'u besosh. Ndoshta ne mendonim se ishin përpara me përgatitjet dhe jo vetëm atë fizike, por pas

Superkupës kuptuam se kemi ende shumë probleme për të zgjedhur dhe duhet të stërvitemi që t'i zgjidhim sa më shpejt, nëse duam që ta nisim mbarë Bundesligën", ka thënë De Ligt.



Kompania Rajonale e Ujësjesit
"Mitrovica" SH.A.
"Rr.Liqeni", p.n. 40000 Mitrovicë-Suhodoll



Konform me funksionet dhe kompetencat që parashihen Nenit 21, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Ndërmarrje Publike (Ligji Nr. 03/L-087), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit të KRU "Mitrovica" Sh.A., me seli në Mitrovicë-Suhodoll, në mbledhjen e mbajtur me datë 11.08.2023, vendosi të shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

Titulli i punës : Zyrtar Kryesor Financiar

Vendi: Mitrovicë-Suhodoll

Ndërmarrja: Kompania Rajonale Ujësjesit, Mitrovica,, Sh.A.

I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv të KRU "Mitrovica" Sh. A. Mitrovicë

Mandati: 3 vite- me mundësi vazhdimi

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (k) dhe (l) dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. **Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:**

- Të ketë diplomë universitare të Fakultetit Ekonomik ose ekuivalente dhe përvojë të konsiderueshme nga fusha e financave dhe/ose kontabilitet.
- Diplomati nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Të ketë së paku 5 vjet përvojë punë në menaxhim të dëshmuar në financa dhe/ose kontabilitet;
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional,
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim,
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi,
- Të mos jetë i dënuar ose nën hetime,
- Njohurit në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sipas udhëzimeve të Federatës ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) do të jenë përparësi;

Funksioni dhe përgjegjësitë kryesore të Zyrtares Kryesore Financiare të përcaktuara me Statutin e kompanisë:

Zyrtari Kryesor Financiar i Shoqërisë ("ZKF") do të menaxhojë, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE, çështjet financiare të Shoqërisë, varësisht prej kufizimeve të vëna nga Këshilli i Drejtorëve- do të ketë autoritetin e lidhjes së të gjitha kontratave financiare për Shoqërinë, dhe do të jetë përgjegjës që:

Të mirëmbajë llogaritë e Shoqërisë të azhuruara dhe të sakta;

Të themelojë dhe udhëheq të gjitha kontrollet e brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme, dhe pasuritë themelore. Të monitoroj llogaritë e pageshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjet speciale. Të rishikojë shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmërinë me politikat e Shoqërisë dhe buxhetin para pagesës së tyre;

Të përgatisë të dhënët e Shoqërisë për auditim në fund të vitit;

Të rishikojë, të arrij marrëveshje për prokurime dhe mirëmbajtje të të gjitha bizneseve të ndërlidhura me politikat e sigurimit;

Të koordinojë funksionet tjera të biznesit, siç janë dhënia me qira e objekteve dhe pajisjeve, si dhe të bëjë blerje me KE dhe zyrën apo funksionin e prokurimit të Shoqërisë;

Menaxhojë thesarin e Shoqërisë;

Të vendos dhe përgatitë buxhetet; dhe

Çfarëdo tjetër detyre e përcaktuar nga ana e KE.

Detyrat dhe përgjegjësitë e ZKF-së janë:

- Përgjigjet për të gjitha veprimet financiare të kompanisë në regjionin që e mbulon kompania.
- Obligohet për bashkëpunim të ngushtë me: Bordin e Drejtorëve dhe Komisionin i Auditimit, Kryeshefin Ekzekutiv, Drejtorin Komercial, Drejtorin Teknik dhe Menaxherët e Departamenteve,
- Ka për detyrë të nxjerr dhe planifikojë buxhetin, të vëzhgojë mospërputhjet. Të përcjellë regjistrimin në kontabilitet, të japë këshilla të gjithë personelit të sektorëve për veprime efektive. Të vëzhgojë-përcjellë qarkullimin e parasë se gatshme dhe transaksionet bankare,
- Përmes Menaxherit Ekzekutiv dhe personelit tjetër, të udhëheqë me ndërmarrjen përpara palëve të interesit (Bordi i Drejtorëve-Aksionari, Komuna, Donatorët). Të sigurojë llogari sipas nevojës që kërkohen për raportimin e ndërmarrjes,
- Përmes personelit nënrenditës, posaçërisht menaxherit ekzekutiv të shitjes, dhe në bashkëpunim të ngushtë me menaxherin ekzekutiv të shërbimit të konsumatorëve, të udhëheqë dhe kontrollojë të hyrat nga: Faturimi dhe inkasimi, mirëmbajtjen e të dhënave të konsumatorëve,

- Të këshillojë përmes Kryeshefit Ekzekutiv në Bordin e Drejtorëve, lidhur me progresin financiar të ndërmarrjes, planet e tanishme të biznesit dhe planet periodike dhe afat gjatë të shpenzimeve dhe aktiviteteve, fluksin e të hyrave dhe shpenzimeve,
- ZKF-zotëron planin e aktivitetit të Kompanisë të specifikuar në çdo Plan të Biznesit,
- Kërkon, propozon, gjen dhe zbaton metoda dhe mënyra për të ndërruar dhe përmirësuar metodat e punës me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të konsumatorëve,
- Siguron se i gjithë personeli është i informuar me synimet dhe misionin e përbashkët të departamenteve, përkatësisht tërësisë së kompanisë,
- Udhëheqë personelin nënrenditës për të siguruar shërbime efektive,
- Vazhdimisht kërkon metoda dhe mënyra për të ndërruar dhe përmirësuar qasjen ndaj punës me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të konsumatorëve,
- Për punën që kryen i përgjigjet Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Paga: Në pajtim me „Rregulloren për ndarjen e të ardhurave personale të KRUM-së „ të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Procedura e aplikimit:

Aplikacioni duhet bashkëngjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Letër motivimi,
- Deklarata nën betim,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diplomat nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmia nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmitë e eksperiencës në punë / referencat (duke pasur të shënuar email-adresat dhe numrat kontaktues),
- Certifikatat (nëse posedon) lidhur me njohurit në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sipas udhëzimeve të Federatës ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK).

Aplikacioni dhe Deklarata nën Betim mund të merren në ueb -faqen e Kompanisë në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset>. Aplikacionet dhe dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen të skanuara ose në formatin .pdf në email adresën: rekrutimi@kru-mitrovica.com.

Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit duke filluar nga data 17.08.2023 deri me datën 15.09.2023.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

KRU "Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë-Suhodoll



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](#)

Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi



Kompanija Regionalnog Vodovoda
"Mitrovica" D.O.,
"Ul."Jezero", b.b. 40000 Mitrovica-Suvi Do

U skladu sa funkcijama i ovlašćenjima prdvidenim Članom 21 u vezi sa članom 17 Zakona o Javnim Preduzećima (Zakon Br. 03/L-087), izmenjen i dopunjen Zakonom Br.04/L-111 i Zakonom br. 05/L-009) za Zakona o Javnim Preduzećima, Upravni Odbor i Komisije za Reviziju KRV "Mitrovica" D.O., sa sedištem u Mitrovici-Suvi Do, na sednici održanoj dana 11.08.2023 godine, odlučio da raspíše ovaj:

JAVNI KONKURS

Radno Mesto : Glavni Financijski Zvaničnik

Mesto: Mitrovica-Suvi Do

Preduzeće: Kompanija Regionalni Vodovod., Mitrovica., D.D.

On Odgovara: Upravnom Odboru i Izvršnom Direktoru KRV „Mitrovica“ D.D. Mitrovica.

Mandat: 3 godine – sa mogućnošću produženja

Uslovi i zahtevane kvalifikacije:

Upravni Odbor želi da se obezbedi da svi potencijalni kandidati budu lica sa poznatim integritetom koji ispunjavaju uslove kvalifikacija prema članu 17.1., ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2. tačka (d), (f), (k) i (l) i imaku potrebno stručno iskustvo i zahtevano školovanje za navedenu poziciju.

Osim ovih opštih uslova, kandidati treba da ispunjavaju i ove posebne uslove:

- Da ima Univerzitetsku diplomu Ekonomskog Fakulteta ili ekuivalent i značajno iskustvo u oblasti i/ili računovodstva.
- Diplome od stranih univerziteta teba da budu nostifikovane od strane Ministarstva prosvete, Nauke i Tehnologije;
- Da ima najmanje 5 godina radnog iskustva u dokaznom menadžmentu i/ili računovodstvu;
- Da ima visok moralni i profesionalni integritet,
- Da ima dokazne sposobnosto upravljanja,
- Poznavanje stranih jezika je prednost,
- Da ne bude osuđen ili pod istragom,
- Znanje u tumačenju Međunarodnih Računovodstvenih Standarda (MRS) i Međunarodnih Standarda Finansijskog Izveštavanja (MSFI), prema uputstvima Međunarodne Federacije Računovođa (MFR) će biti prioritet;

Funkcionisanje i glavne odgovornosti Glavnog Financijskog Zvaničnika određene Statutom Kompanije:

Glavni Financijski Zvaničnik Društva (GFZ) će upravljati pod upravom i nadzorom IO, finansijske poslove društva, podležu graničenjima koja nameće Upravni odbor – imat će autoritet veze svih finansijskih ugovora za Društvo, i bit će odgovoran da:

Da održava račune Kompanije ažurnim i tačnim.

Da uspostavi i upravlja svim internim finansijsim kontrolama, uključujući nabavke, gotovinskog novca i osnovna sredstva. Da prati dugovanja i koordinira plaćanje računha i posebne kupovine. Da pregleda troškove zaposlenih kako bi se osigurala usklađenost sa politikama kompanije i njihovim budžetom pre njihovih isplata.

Da pripremi podatke Kompanije za reviziju na kraju godine;

Da preispita postizanje sporazuma za nabavku i održavanje shih poslova vezanih sa politikama obezbeđenja;

Da koordinira ostale funkcije poslovanja, kao što su izdavanje objekata i opreme pod zakum, kao i da vrši kupovinu za EK i kancelarijom ili funkcijom nabavke kompanije.

Da menadžita trezorom Kompanije;

Da odlučuje i pripremi budete, i

I bilo koji drugi zadatak koji odredi EK.

Zadaci i odgovornosti GFZ su;

- Odgovara za sve finansijske postuake kompanije u rgiji koju pokriva kompania. .
- Obavezuje se za usku saradnju sa: Upravni Odbor i Komisije za Reviziju, Izvršnim Direktorom, Komercijalnim Direktorom, Tehničkim Direktorom i sa rukovodiocima odeljenja.
- ma za zadatak da izradi i planira budžet, da prato neslaganja . Da prati registraciju u računovodstvu, da daje savete čitavom osoblju sektora za efektivne postuake. Da prati promet gotovog noca i bankarskih transakcija.
- Preko Izvršnog Direktora o ostalog osoblja, da rukovodi sa preduzećem pred stranama interesa (Bord Direktora-Akcionari, Opština, Donatori). Da obezbedi rakun po potrebi koji se zahtevaju za izveštavanje preduzeća.
- Preko podređenog osoblja, posebno izvršnog direktora prodaje, i u uskoj saradnji sa izvršnim direktorom usluga potrošača, da rukovodi i kontroliše prihode od: Fakturisanja i inkasiranja, odražavanje podataka potrošača.
- Da savetuje preko Glavnog Izvršnog Direktora u Upravnom Odboru, u vezi sa finansijskim progresom preduzeća, sadašnje planove poslovanja i periodične i dugoročne planove trokova i aktivnosti, tok prihoda i rashoda.
- GFZ-poseduje poslovni plan Kompanije specifikovane u vaki Plan

- Zahteva, predlaže, namazi i sprovodi metode i načine za promenu i popravku metoda rada sa namerom poboljšanja usluga potrošača.
- Obezbeđuje da svo osoblje bude informisano sa namerama i zajedničkom misijom odelenj, odnosno celine kompanije,
- Vodi podređeno osoblje kako bi osigurali efikasne usluge,
- Stalno traži metode i načine da prometi i popravi pristup prema radu sa namerom popravljavanja usluga potrošača.,
- Za obavljene posao odgovara Upravnom Odboru i Glavnom izvršnom Direktoru.

Plata: U skladu sa "Pravilnikom o raspodeli ličnih primarja KRVM" usvojeno od strane Upravnog Odbora. .

Procedura aplikacije:

Aplikaciji treba priložiti i sledeća dokumenta:

- CV-ja (Biografija),
- Kopija lisne karte,
- Motivaciono pismo,
- Izjava pod zakletvom,
- Univerzitetska Diploma (notarizovana kopija, dok diplome sa univerziteta van zemlje treba da budu nostrifikovane),
- Dokaz od i nadležnog suda da nije pod istragom, ne starija od 6 meseci,
- Dokazi o stručnoj spremi,
- Dokazi o radnom iskustvu/ reference (navodeći imejl adrese i kontakt brojeve)
- Sertifikati (ukoliko ih poseduje) u vezi sa Znanjem u tumačenju Međunarodnih Računovodstvenih Standarda (MRS) i Međunarodnih Standarda Finansijskog Izveštavanja (MSFI), prema uputstvima Međunarodne Federacije Računovođa (MFR) će biti prioritet;

Aplikacije mogu da se uzmu u direkciji Kompanije (ili veb-stranici Kompanije) na adresi : <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset>. Aplikacija i prateća dokumenta treba da se predaju skenirano ili u .pdf formatu na mejl adresu: rekrutimi@kru-mitrovica.com

Konkurs će biti ovoren 30 dana od dana objavljivanja u sredstvima informisanja pocevsi od dana 17.08.2023 do 15.09.2023.

Prijave podnete nakon roka se ne prihvataju, a nepotpune se odbijaju..

KRV "Mitrovica" D.D. Mitrovic-Suvi Do.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref. AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 193/2023 të datës 23 Shkurt 2023, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

K O N K U R S
PËR PUNËSIM ME KOHË TË CAKTUAR

I. Menaxher i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, një (1) pozitë

Referenca:	KPK/ZKPSH/ZMNV/POZ- 001
Emri pozitës:	Menaxher i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
Pozita:	Pozitë jo e karrierës
Niveli:	Drejtues i mesëm
Raporton tek:	Kryeprokurori i Shtetit, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së
Numri i pozitave:	Një (1) pozitë
Koeficienti:	8,6
Akti i emërimit:	Me afat të caktuar, deri më 14.06.2025
Periudhë provuese:	(Tre) 3 muaj
Vendi :	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, mbikëqyrja, koordinimi dhe menaxhimi i punës së gjithmbarshme të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, duke përcaktuar politikën, standardet dhe veprimet në përputhje me legjislacionin përkatës. Harton programe, projekte, strategji dhe kujdeset për implementimin e tyre në mënyrë aktive, menaxhon me mjetet buxhetore dhe donacionet e ndryshme të siguruar për ZMNV. Koordinon punën në nivel të institucionit të prokurorit të shtetit dhe me partnerët e jashtëm dhe ndërkombëtar.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Menaxhon me punën e gjithmbarshme të zyrës së ZMNV-së dhe personelin e saj, përfaqëson zyrën brenda institucionit të PSH dhe para institucioneve tjera në vend dhe jashtë vendit; Koordinon punën me vartësit e vet lidhur me zbatimin e objektivave të punës, mbështetur në strategjinë, planet dhe ligjin; Kujdeset për hartimin dhe implementimin e politikave për ZMNV, duke i harmonizuar procedurat e brendshme në përputhje me ligjet e aplikueshme; Përgjegjës për sigurimin e hapësirave dhe kushteve për punë të punësuarve në bashkëpunim me strukturën organizative dhe zyrat e institucionit të PSH-së;

- Merr pjesë në organizimin e programeve të ndryshme që kanë të bëjnë me mandatin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave;

Këshillon stafin e ZMNV-së, lidhur me zbatimin e procedurave dhe projekteve që kanë të bëjnë me Mbrojtjen e Viktimave;

Raporton në periudha të përcaktuara në nivel të institucionit të PSH-së, mbi punën dhe të arriturat e ZMNV-së;

Ndërmerr të gjitha veprimet ligjore ndaj personelit të ZMNV-së, në të gjitha nivelet për zbatimin e politikave dhe përgjegjësi të secilit të punësuar dhe është përgjegjës për të njëjtit.

Njohuritë, shkathësitë aftësitë për vendin e punës:

Aftësi të larta komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
Qasje fleksibile ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës së Zyrës për zgjidhjen e problemeve profesionale dhe organizative të rëndësishme për institucionin;
Njohuri të thella dhe të specializuara për kryerje e punëve të MV;
Njohuri të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point, etj);
Shkathësi komunikuese me sjellje korrekte të besueshme dhe konfidenciale;
Shkathësi për hartim të akteve dhe shkresave dhe komunikim;
Shkathësi për të caktuar prioritetet e shqyrtimit të rasteve që ndërlidhen me punën e MV.;

Të jetë i trajnuar në fushën e MV;

Gatishmëri të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;

Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me të;

Aftësia për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion;

Aftësi të përgjithshme për raportim të rezultateve të arritura të punës si MV, Reagimi duhur në zgjidhjen e problemeve.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik.

Përvoja e Punës:

Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale.

Katër (4) vite përvojë pune në vende udhëheqëse.

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendrike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, duke filluar nga data 17.08.2023 deri me datë 31.08.2023 si datë e mbylljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org.
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati IV, objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, rruga "Luan Haradinaj", 10000 Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", kati i IV, objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:
 - Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe do të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
